

URDHËR
Nr. 273, datë 23.9.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI MASAT E KONTROLLIT TË
SALMONELËS DHE AGJENTËVE TË TJERË ZOONOTIKË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 16, pika 1, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2019 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 23, pika 1 dhe pika 2, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmoneles dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

RREGULLORE
**MBI MASAT E KONTROLLIT TË SALMONELOZËS DHE AGJENTËVE TË TJERË
ZOONOTIKË**

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i programit vjetor të kësaj rregulloreje është të përcaktojë marrjen e masave të duhura dhe efektive për të gjurmuar dhe kontrolluar salmonelozën dhe agjentët e tjerë zoonotikë në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes, veçanërisht, në nivel të prodhimit primar, përfshirë këtu edhe ushqimin, për të bërë të mundur uljen e prevalencës së tyre dhe rrezikun që këta agjentë paraqesin në nivel të shëndetit publik.

2. Kjo rregullore zbatohet, për:

a) përcaktimin e objektivave të programit për uljen e prevalencës së zoonozave specifike në popullatat e kafshëve, në:

i. nivel prodhimi primar; dhe

ii. gjurmimin e zoonozave ose agjentëve zoonotikë në fjalë, në faza të tjera të zinxhirit ushqimor, përfshirë këtu ushqimin dhe ushqimin për kafshë;

b) programet specifike të kontrollit, që zbatohen nga operatorët e biznesit ushqimor dhe ushqimit për kafshë;

c) rregullat specifike, në lidhje me metoda të ndryshme kontrolli që përdoren për të ulur prevalencën e zoonozave dhe agjentëve zoonotikë;

ç) rregullat në lidhje me tregtinë brenda vendit dhe importet që vijnë nga vendet e tjera drejt Republikës së Shqipërisë, të disa lloje kafshësh dhe produkteve të tyre.

3. Kjo rregullore nuk zbatohet për fazën e prodhimit primar:

- a) për përdorim vetjak; ose
- b) furnizimin e drejtpërdrejt, nga prodhuesi, në sasi të vogla të produkteve primare, për konsuatorin përfundimtar ose nga operatorët e shitjes me pakicë, që furnizojnë drejtpërdrejt me produkte konsumatorin përfundimtar.

Veprimtaritë e përcaktuara në pikën 3, shkronja “b”, të këtij neni, bëhen sipas udhëzimit nr. 5, datë 4.5.2018 “Për përjashtimin nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit për operatorë të veçantë të biznesit ushqimor”.

4. Kjo rregullore zbatohet pa paragjykuar legjislacionin në shëndetin e kafshëve, ushqyerjen e kafshëve, higjienën e ushqimit, sëmundjet e transmetueshme te njeriu, shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës, teknologjinë gjenetike dhe encefalopati të spongiforme të transmetueshme.

Neni 2 **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj rregullore, termit e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, si dhe të urdhrin nr. 327, datë 22.11.2012 “Për miratimin e rregullores “Mbi monitorimin e zoonozave dhe agjentëve zoonotikë” kanë të njëjtin kuptim.

Ndërsa termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

- a) “Tufë shpendësh” janë të gjithë shpendët me të njëjtin status shëndetësor, të ruajtur në të njëjtin mjedis, ose në të njëjtin kufizim mjedisor dhe që përbëjnë një njësi të vetme epidemiologjike. Në rastin e stabilimenteve të shpendëve kjo përfshin të gjithë zogjtë që ndajnë të njëjtën hapësirë mjedisore.

Neni 3 **Strukturat përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e programeve të kontrollit të salmonelozës**

1. Strukturat përgjegjëse për sigurinë ushqimore dhe shërbimin veterinar në ministri janë përgjegjës, për:

- a) hartimin e programit të kontrollit të përshkruara në nenin 5, pika 1 dhe përgatitjen e amendimeve të nevojshme, që pasqyrojnë të dhënat dhe rezultatet e marra;
- b) mbledhjen e të dhënave të nevojshme nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për të vlerësuar metodat e përdorura dhe rezultatet e arrira nga zbatimi i programeve të kontrollit të përcaktuara në nenin 5, të kësaj rregulloreje.

2. AKU-ja kryen kontrole të rregullta në stabilimentet e ushqimit dhe nëse është e nevojshme të operatorëve të ushqimit për kafshë, me qëllim kontrollin dhe përputhshmërinë me këtë rregullore.

3. Kontrolli në lidhje me përputhshmërinë me këtë rregullore në popullatat e kafshëve kryhet nga Shërbimi Veterinar Rajonal.

Neni 4 **Masat për uljen e prevalencës së zoonozave dhe agjentëve zoonotikë**

1. Masat synojnë uljen e prevalencës së zoonozave dhe agjentëve zoonotikë të listuar në shtojcën I, kolona 1, bashkëlidhur, në popullatat e kafshëve, të listuar në shtojcën I, kolona 2, bashkëlidhur, duke marrë parasysh kryesisht:

- a) përvojën e fituar nga zbatimi i masave ekzistuese;
- b) informacionin e grumbulluar gjatë monitorimit.

2. Masat për uljen e prevalencës së zoonozave dhe agentëve zoonotikë, sipas pikës 1, të këtij neni, konsistojnë në:

a) në shprehje numerike, të:

i. përqindjes maksimale të njësive epidemiologjike që mbeten pozitive; dhe/ose

ii. përqindjes minimale dhe të reduktimit në numër të njësive epidemiologjike që mbeten pozitive;

b) afatin kohor maksimal brenda të cilit duhet të arrihen objektivat;

c) përkufizimin e njësive epidemiologjike të përmendura në shkronjën “a”;

ç) përcaktimin e skemave të testimit të nevojshëm për të verifikuar arritjen e objektivave;

d) përkufizimin kur është e nevojshme, të serotipave më me rëndësi për shëndetin publik ose të nëntipave të tjerë, të zoonozave ose agentëve zoonotikë të listuar në shtojcën I, kolona 1, duke marrë parasysh kriteret e përgjithshme të listuara në pikën 6, të këtij neni, shkronja “b” dhe çdo kriter specifik të caktuar në shtojcën III bashkëlidhur.

3. Kur përcaktohen masat që do të merren për uljen e prevalencës së zoonozave dhe agentëve zoonotikë, sigurohet një analizë e kostove dhe përfitimeve të pritshme. Kjo analizë do të marrë parasysh, kriteret e përcaktuara në pikën 6, shkronja “b”:

a) para se të propozojë çdo masë, strukturat përgjegjëse sipas nenit 3, të kësaj rregullore do të konsultojnë rezultatet e analizës;

b) në dritën e rezultateve të kësaj analize dhe konsultimeve të kryera, strukturat përgjegjëse propozojnë synimet ku do të arrihet, kur është e përshtatshme.

4. Megjithatë, pavarësisht pikës 2, shkronja “d” dhe pika 4 e këtij neni, rregullat e mëposhtme do të zbatohen për shpendët për një periudhë kalimtare. Objektivi i vendosur për tufat e mbarështimit të *Gallus gallus* për periudhën kalimtare, do të përfshijë pesë serotipat më të shpeshta të salmonelave përgjegjëse për shkaktimin e salmonelozës në njerëz, të cilat do të identifikohen në bazë të të dhënave të mbledhura përmes gjurmimeve zyrtare. Objektivat e vendosur për vendosjen e pulave, broilerave dhe gjelave të detit në periudhën kalimtare do të përfshijë *Salmonella Enteritidis* dhe *Salmonella Typhimurium*. Këta objektiva mund të përfshijnë serotipa të tjerë, bazuar në rezultatet e një analizimi të kryer në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

5. Shtojca I, mund të ndryshohet për qëllime të listuara në shkronjën “a”, duke marrë parasysh veçanërisht kriteret e listuara në shkronjën “b”:

a) ndryshimet në shtojcën I, mund të ndryshojnë qëllimin e kërkesave në lidhje me përcaktimin e stabilimenteve duke plotësuar, kufizuar ose ndryshuar:

i. zoonozat ose agentët zoonotikë;

ii. fazat e zinxhirit ushqimor; dhe/ose

iii. popullatat e kafshëve në fjalë.

b) kriteret që duhet të merren parasysh përpara ndryshimit të shtojcës I, përfshijnë në zoonozat ose agentët zoonotik:

i. shpeshësinë e tyre në popullatat e kafshëve dhe njerëzve, ushqimin dhe ushqimin për kafshë;

ii. shkallën e përhapjes në njerëz;

iii. pasojat e tyre ekonomike për kujdesin shëndetësor të kafshëve dhe të njerëzve dhe për bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë;

iv. tendencat epidemiologjike në popullatat e kafshëve dhe njerëzve, ushqimin dhe ushqimin për kafshë;

v. këshilla shkencore;

vi. zhvillimet teknologjike, veçanërisht në lidhje me praktikën e mundësive të kontrollit;

vii. kërkesat dhe të rejat më të fundit në lidhje me sistemet e mbarështimit dhe metodologjitë e prodhimit.

Neni 5

Programet e kontrollit

1. Për të arritur objektivat e parashikuar në nenin 4, strukturat përgjegjëse për sigurinë ushqimore dhe Shërbimin Veterinar në ministri, hartojnë programet e kontrollit për secilën zoonozë dhe agjent zoonotik të listuar në shtojcën I. Programet e kontrollit do të kenë parasysh shpërndarjen gjeografike të zoonozës brenda vendit dhe ndikimet financiare për prodhuesit kryesorë dhe operatorët e biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, për vendosjen e kontrolleve efektive.

2. Programet e kontrollit duhet të jenë të vazhdueshme dhe të mbulojnë një periudhë të paktën për tre vjet, radhazi.

3. Programet e kontrollit, duhet të:

a) parashikojnë zbulimin e zoonozës dhe agjentëve zoonotikë në përputhje me kërkesat dhe rregullat minimale të marrjes së mostrave të përcaktuara në shtojcën II;

b) përcaktojnë përgjegjësitë përkatëse të strukturave përgjegjëse për Sigurinë Ushqimore dhe Shërbimin Veterinar dhe operatorëve të biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë;

c) specifikojnë masat e kontrollit që duhen ndërmarrë pas zbulimit të zoonozës dhe agjentëve zoonotikë, veçanërisht për të mbrojtur shëndetin publik, përfshirë zbatimin e masave specifike të përshkruara në shtojcën II;

ç) lejojnë vlerësimin dhe rishikimin e ecures së masave të marra, veçanërisht nga rezultatet e marra nga zbulimi i zoonozave dhe agjentëve zoonotikë.

4. Programet e kontrollit duhet të përfshijnë të paktën fazat e mëposhtme të zinxhirit ushqimor:

a) prodhimin e ushqimit për kafshë;

b) prodhimet primare që origjinojnë nga kafshët;

c) përpunimi dhe përgatitja e ushqimit me origjinë shtazore.

5. Programet e kontrollit të përmbajnë, kur është e përshtatshme, metodat dhe kriteret e testimit, ndaj të cilave rezultatet e këtyre testeve do të vlerësohen, për testimin e kafshëve dhe vezëve për çelje, si pjesë e kontrolleve zyrtare të parashikuara në shtojcën II, pjesa A.

6. Shqipëria dërgon programin kombëtar të kontrollit, në përputhje me nenin 5, në Komisionin Evropian. Në rast se Komisioni Evropian kërkon informacion të mëtejshëm dhe të nevojshëm nga Shqipëria në lidhje me programet kombëtare të kontrollit, Shqipëria siguron informacionin e kërkuar brenda afatit nga marrja e një kërkesë të tillë.

Neni 6

Programet e kontrollit të operatorëve të biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë

1. Operatorët e biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, mund të përgatisin programe kontrolli, për mbulimin e të gjithave fazave të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes.

2. Operatorët e biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë mund të dërgojnë në strukturat përgjegjëse në ministri programin e tyre të kontrollit dhe çdo amendim në të, nëse ata dëshirojnë që programet e tyre të kontrollit të jenë pjesë e një programi kombëtar kontrolli.

3. Strukturat përgjegjëse për Sigurinë Ushqimore dhe Shërbimin Veterinar në ministri mund të pranojnë programet e kontrollit të paraqitura në bazë të pikës 2, vetëm nëse janë të bindur që programet e kontrollit përputhen me kërkesat përkatëse të përcaktuara në shtojcën II dhe me objektivat e programit përkatës kombëtar të kontrollit.

4. Ministria mban listat e përditësuara të programeve të kontrollit të operatorëve të biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë të cilat janë pjesë e një programi kombëtar kontrolli.

5. Operatorët e biznesit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë të raportojnë rregullisht në MBZHR dhe AKU, rezultatet e programit të tyre të kontrollit.

Neni 7

Tregtia e brendshme

Speciet e tufave të shpendëve dhe të kafshëve, të listuara në kolonën 2, të shtojcës I, duhet të testohen për zoonozat dhe agentët zoonotikë të listuar në kolonën 1, të shtojcës I, përpara nisjes së çdo dërgese të kafshëve, ose vezëve për çelje, nga subjekti. Data dhe rezultati i testimit, duhet të përfshihen në certifikatat përkatëse shëndetësore.

Neni 8

Importet

Importimi nga vendet e treta të kafshëve ose vezëve për çelje të përcaktuara në këtë rregullore do të bëhet vetëm nëse këto vende zbatojnë një program kontrolli të barasvlershëm me ato të parashikuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje dhe miratimi i tij është bërë nga Shërbimet e Komisionit Evropian.

LABORATORËT

Neni 9

Laboratorët e referencës

1. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është qendra kombëtare e referencës për analizimin dhe testimin e zoonozave dhe agentëve zoonotikë të listuar në shtojcën I, kolona 1.

2. Si metoda reference përdoren metodat dhe protokollet e rekomanduara nga standardet ndërkombëtare.

Neni 10

Miratimi i laboratorëve, kushtet për cilësinë dhe metodat e aprovuara të testimeve

1. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, merr pjesë në programet e kontrollit, në përputhje me nenet 5 dhe 7 të kësaj rregullore, për qëllime analizimi të mostrave për të provuar praninë e zoonozave dhe agentëve zoonotikë të përmendur në shtojcën I, kolona 1, duhet të aplikojë sisteme të sigurimit të cilësisë, që përputhen me kërkesat e standardit aktual EN/ISO jo më vonë se brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore ose brenda 24 muajve nga shtimi i zoonozave të reja ose agentëve zoonotikë në shtojcën I, kolona 1.

2. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë pjesë rregullisht në testime të organizuara ose të koordinuara nga laboratorët ndërkombëtarë të referencës.

3. Testimi për praninë e zoonozave dhe agentëve zoonotikë, të përmendur në shtojcën I, kolona 1, të bëhet duke përdorur metodat dhe protokollet e rekomanduara nga organet ndërkombëtare të standardizimit, si metoda reference. Metodot alternative mund të përdoren nëse ato janë vërtetuar në përputhje me rregullat e njohura ndërkombëtarisht dhe ofrojnë rezultate të barasvlershme me ato të marra me metodën përkatëse të referencës.

SHTOJCË I

Zoonozat specifike dhe agjentët zoonotikë për të cilët objektivi është ulja e prevalencës që përcaktohen në bazë të nenit 4.

1. Zoonozat ose agjenti zoonotik	2. Popullata e kafshëve	3. Faza e zinxhirit ushqimor
Të gjithë serotipat e salmonelave me rëndësi për shëndetin publik	Ekonomitë e pulave <i>Gallus gallus</i>	Prodhimi primar
Të gjithë serotipat e salmonelave me rëndësi për shëndetin publik	Pulat për vezë	Prodhimi primar
Të gjithë serotipat e salmonelave me rëndësi për shëndetin publik	Broiler	Prodhimi primar
Të gjithë serotipat e salmonelave me rëndësi për shëndetin publik	Gjela deti	Prodhimi primar
Të gjithë serotipat e salmonelave me rëndësi për shëndetin publik	Tufat e derrave për therje	Prodhimi primar
Të gjithë serotipat e salmonelave me rëndësi për shëndetin publik	Ekonomitë e rritjes së derrave	Prodhimi primar

SHTOJCË II

A. kërkesat e përgjithshme të programit kombëtar të kontrollit

Programi të marrë parasysh natyrën e zoonozës dhe/ose agjentit zoonotik në fjalë dhe situatën specifike të vendit.

Programi:

- a) të përcaktojë qëllimin duke marrë parasysh rëndësinë e zoonozës ose agjentit zoonotik në fjalë;
- b) të jetë në përputhje me kërkesat minimale të marrjes së mostrave të përcaktuara në pjesën B;
- c) të jetë në përputhje me kërkesat specifike të përcaktuara në pjesët C deri në E, aty ku është e përshtatshme;

ç) të specifikojë pikat e mëposhtme:

1. Të përgjithshme

1.1 Shfaqjen e zoonozave dhe agjentëve zoonotikë të marrë në konsideratë nga Struktura Përgjegjëse për Veterinarinë (SPV), duke iu referuar, veçanërisht, rezultateve të marra në kuadër të monitorimit, sipas nenit 4, të kësaj rregulloreje.

1.2 Zonat gjeografike ose njësitë epidemiologjike, në të cilat programi do të zbatohet.

1.3 Struktura dhe organizimi i shërbimit veterinar përkatës.

1.4 Laboratorët e autorizuar ku do të analizohen mostrat e mbledhura brenda programit.

1.5 Metodatat e përdorura në ekzaminimin e zoonozave ose agjentit zoonotik.

1.6 Kontrollat zyrtare (përfshirë skemat e marrjes së mostrave) në ushqim, tufat e shpendëve ose tufat e kafshëve.

1.7 Kontrollat zyrtare duke përfshirë skemat e marrjes së mostrave, në fazat e tjera të zinxhirit ushqimor.

1.8 Masat e marra nga ARSHVMB-ja dhe AKU-ja në lidhje me kafshët ose produktet në të cilat janë zbuluar zoonozat ose agjentët zoonotikë, veçanërisht për të mbrojtur shëndetin publik dhe çdo masë parandaluese të ndërmarrë, siç është vaksinimi.

1.9 Legjislacionin ku bazohet.

2. Në lidhje me bizneset ushqimore dhe ato të ushqimeve për kafshë të mbuluara nga programi duhet të specifikohet:

2.1 Struktura e prodhimit të specieve të caktuara dhe produkteve të tyre.

2.2 Struktura e prodhimit të ushqimeve për kafshë.

2.3 Udhëzimet përkatëse për praktikën e mira të mbarrështimit të kafshëve ose udhëzime të tjera (të detyrueshme ose vullnetare) që përcaktojnë të paktën:

- menaxhimin e higjienës në fermë;
- masat parandaluese kundrejt hyrjes së infeksioneve me origjinë nga kafshët;
- ushqimi për kafshë, uji i pijshëm, personeli i fermës; dhe
- higjienën gjatë transportit të kafshëve për në dhe jashtë fermës.

2.4 Mbikëqyrja veterinare rutinë në fermë.

2.5 Regjistrimi i fermave.

2.6 Mbajtja e të dhënave në fermë.

2.7 Dokumente shoqëruese për lëvizjen e kafshëve.

2.8 Masat të tjera të rëndësishme për të siguruar gjurmueshmërinë e kafshëve.

B. Kërkesat minimale për marrjen e mostrave

1. Pasi të jetë miratuar programi përkatës i kontrollit, sipas nenit 5, operatorët e biznesit, duhet të marrin dhe analizojnë mostra për të provuar prezencën e zoonozave dhe agjentëve zoonotikë të listuar në shtojcën I, kolona 1, duke respektuar kërkesat minimale për marrjen e mostrave të paraqitura në tabelën vijuese.

2.1 Zoonozat ose agjenti zoonotik	3.2 Popullata e kafshëve	3.3 Fazat e prodhimit që mbulohen nga kampionimi
Të gjithë serotipat e salmonelës me rëndësi për shëndetin publik	- Tufat e mbarrështimit të <i>Gallus Gallus</i> :	- Zogj një ditësh
	- Fermat e tufave të shpendëve	- Zogj një ditësh - Zogj katër javësh - Dy javë para fillimit të prodhimit ose lëvizjes në sektorin e vezëve
	- Tufat e shpendëve të rritur	- Çdo dy javë gjatë periudhës së prodhimit të vezëve
Të gjithë serotipat e salmonelës me rëndësi për shëndetin publik	Pulat e vezëve:	
Të gjithë serotipat e salmonelës me rëndësi për shëndetin publik	- Fermat e tufave të shpendëve	- Pula njëditëshe
	- Tufat e pulave të vezëve	- Zoga dyjavëshe para lëvizjes për në fazën e vezëve ose në njësinë e prodhimit të vezëve
Të gjithë serotipat e salmonelës me rëndësi për shëndetin publik	Broilerët	Zogj të dërguar për therje (*)
Të gjithë serotipat e salmonelës me rëndësi për shëndetin publik	Gjelat e detit	Zogj të dërguar për therje (*)
Të gjithë serotipat e salmonelës me rëndësi për shëndetin publik	Tufat e derrave: - derrat për mbarrështim - derrat për therje	Kafshë të dërguara për therje ose karkasat në thertore. Kafshë të dërguara për therje ose karkasat në thertore.

Të gjitha rezultatet e analizave të jepen përpara se kafshët të nisen për në thertore.

3. Kërkesat e përcaktuara në pikën 1 nuk duhet të cenojnë kërkesat e legjislacionit në lidhje me inspektimin *ante mortem*.

4. Rezultatet e analizave të regjistrohen, së bashku me informacionin e mëposhtëm:

a) datën dhe vendin e marrjes së mostrave;

b) identifikimin e tufës ose grupit të shpendëve dhe kafshëve.

5. Testimi imunologjik nuk përdoret nëse kafshët janë të vaksinuara, përveç rasteve nëse është vërtetuar se vakcina e përdorur nuk interferon me metodën e testimit të përdorur.

C. Kërkesat specifike në lidhje me tufat e mbarështimit të pulave *Gallus gallus* dhe gjelave të detit

1. Masat e përcaktuara në pikat 3 deri 5 duhet të merren sa herë që analizat e mostrave të marra në përputhje me pjesën B, ose në përputhje me skemat e testimit tregojnë praninë e *Salmonella Enteritidis* ose *Salmonella Typhimurium* në një tufë mbarështimi të pulave *Gallus gallus* ose të gjelave të detit, sipas rasteve të përcaktuara në pikën 2.

2. Nëse metoda e analizës së përdorur për mostrat e marra në përputhje me pjesën B është e aprovuar, masat e përcaktuara në pikat 3 deri 5 merren, kur një analizë e tillë zbulon praninë e *Salmonella Enteritidis* ose *Salmonella Typhimurium*. Në rast të kundërt, masat e përcaktuara në pikat 3 deri 5 duhet të merren sa herë që Shërbimi Veterinar konfirmon një dyshim për praninë e *Salmonella Enteritidis* ose *Salmonella Typhimurium* që rrjedh nga analizat e mostrave të marra në përputhje me pjesën B.

3. Vezët e pa inkubuara nga tufat e shpendëve duhet të shkatërrohen.

4. Të gjithë shpendët, përfshirë zogjtë një ditësh, në tufa, duhet të theren ose shkatërrohen në mënyrë që të zvogëlohet sa më shumë që të jetë e mundur rreziku i përhapjes së salmonelës. Therja kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Produktet që rrjedhin nga këto shpendë mund të vendosen në treg për konsum njerëzor në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi të jetë e zbatueshme, pjesa E. Nëse nuk destinohen për konsum njerëzor, produkte të tilla duhet të përdoren ose të propozohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Kur *Salmonella Enteritidis* ose *Salmonella Typhimurium* është e pranishme në vezët për çelje dhe në pulari, ato duhet të shkatërrohen ose të trajtohen.

6. Të gjitha referencat në këtë seksion për *Salmonella Typhimurium*, gjithashtu, përfshijnë shtamet monofazikë *Salmonella Typhimurium* me një formulë antigjenike.

D. Kërkesat specifike në lidhje me tufat e pulave për vezë

1. Vezët nuk duhet të përdoren për konsum të drejtpërdrejtë human, përveç rasteve kur ato kanë origjinën nga një tufë tregtare e pulave për vezë, që kanë qenë subjekt i një programi kombëtar kontrolli të vendosur në nenin 5 dhe jo nën një kufizim zyrtar.

2. Vezët me origjinë nga tufat me status të panjohur shëndetësor, ku dyshohet se janë të infektuar, ose që janë të infektuar me serotipa salmonelash, për të cilat është caktuar një objektiv për reduktimin, ose të cilat janë identifikuar si burim infeksioni specifik në produktet ushqimore për konsum human, të përdoren për konsum human vetëm nëse trajtohen në atë mënyrë që garanton shkatërrimin e të gjithë serotipave të salmonelave me rëndësi në shëndetin publik në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Vezët me origjinë nga tufat me gjendje të panjohur shëndetësore, që dyshohet se janë të infektuar ose që janë të infektuar me serotipa salmonelash, për të cilat është caktuar një objektiv për reduktimin, ose të cilat janë identifikuar si burim infeksioni specifik në produktet ushqimore për konsum human, duhet:

a) të konsiderohen si vezë të klasit B;

b) të shënohen me treguesin e një rrethi prej 12 mm, i cili rrethon shkronjën B që është me diametër 5 mm në lartësi dhe në diametër, i cili i dallon qartë ato nga vezët e klasit A përpara se të hidhen në treg;

c) të ndalohet hyrja në qendrat e paketimit përveç rasteve kur janë marrë masat parandaluese, të kontaminimit të mundshëm të kryqëzuar të vezëve nga tufat e tjera.

4. Kur zogjtë nga tufat e infektuara thehen ose shkatërrohen, duhet të ndërmerren hapa për të ulur sa më shumë që të jetë e mundur, rrezikun e përhapjes së zoonozave. Thërja duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Produktet që rrjedhin nga zogj të tillë mund të vendosen në treg për konsum human, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi të jetë e aplikueshme pjesa E.

5. Për të përjashtuar rezultatet fillestare false-pozitive, SPV mund të heqë kufizimet e përcaktuara në pikën 2, të kësaj pjese:

a) kur tufat e pulave për vezë nuk janë burim i infeksionit për njerëzit nga konsumi i vezëve ose produkteve të vezëve që vjen si rezultat i hetimit epidemiologjik të shpërthimeve të shkaktuara nga ushqimi;

b) kur tufat e pulave për vezë i nënshtrohen një programi kombëtar të kontrollit të hartuar sipas nenit 5 dhe serotipat e salmonelave për të cilat është caktuar një objektiv për uljen e tyre, nuk konfirmohet nga protokoll i mëposhtëm i marrjes së mostrave të kryer nga shërbimi veterinar:

i. në një mostër prej 25 gramësh duhet të mblidhet nga secili material fekal dhe mostra pluhuri, për analizë. Të gjitha mostrat duhet të analizohen veçmas; ose

ii. hetimi bakteriologjik i cekumeve dhe i ovidukteve të 300 zogjve;

iii. hetimi bakteriologjik i guaskës dhe përmbajtja e 4 000 vezëve të secilës tufë në kampionaturat përfaqësuese, me maksimum 40 vezë.

Përveç marrjes së mostrave në shkronjën “b”, Shërbimi Veterinar Rajonal duhet të verifikojë mungesën e përdorimit të antibiotikëve, të cilët ndikojnë potencialisht në rezultatet e analizave të mostrave.

E. Kërkesa specifike në lidhje me mishin e freskët

1. Mishi i freskët i pulave nga popullatat e listuara në shtojcën I, duhet të plotësojë kriterin mikrobiologjik përkatës të përcaktuar në të urdhrit nr. 234, datë 20.5.2014 “Për kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”, i ndryshuar.

2. Kriteri i parashikuar në pikën 1, nuk vlen për mishin e freskët të pulave të destinuara për trajtim industrial me nxehtësi ose një trajtim tjetër për të eliminuar salmonelën, në përputhje me legjislacionin në fuqi për higjienën e ushqimit.

SHTOJCË III

KRITERE SPECIFIKE PËR TË PËRCAKTUAR SEROTIPAT E SALMONELËS ME RËNDËSI PËR SHËNDETIN PUBLIK

Kur përcaktohen cilat janë serotipat e salmonelës me rëndësi për shëndetin publik, të merren parasysh këto kritere:

a) serotipat më të shpeshtë të salmonelës në salmonelozën humane në bazë të të dhënave të mbledhura përmes sistemeve të monitorimit;

b) rruga e infeksionit (domethënë prania e serotipit në popullatat përkatëse të kafshëve dhe ushqim);

c) nëse ndonjë serotip tregon një aftësi të shpejtë për t'u përhapur dhe për të shkaktuar sëmundje te njerëzit dhe të kafshët;

ç) nëse ndonjë serotip tregon një virulencë të lartë, për shembull, në lidhje me invazivitetin ose rezistencën ndaj terapive përkatëse për infeksione njerëzore.